





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria Infrastrukturës
Ministarstvo Infrastrukture
Ministry of Infrastructure

Prishtinë, 09.02.2021

MARRËVESHJE PËR BASHKËFINANCIMIN E PROJEKTEVE INFRASTRUKTURE NË KOMUNËN E VUSHTRRIË

Neni 1
Palët Nënshkruese

1. **MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS**, e përfaqësuar nga Ministri i MI-se, (në tekstin e mëtejme MI),

dhe

2. **KOMUNA E VUSHTRRIË**, e përfaqësuar nga Kryetari i Komunës, (në tekstin e mëtejme Komuna).

Neni 2
Qëllimi

Qëllimi i kësaj Marrëveshje është financimi i projekteve infrastrukturore të cekura më poshtë si dhe përcaktimi i obligimeve të MI-së dhe Komunës për realizimin e projekteve:

- Ndërtimi i rrugëve në fshatrat: Studime e eperme, Sllatinë, Stanofc i epërm dhe Smrekovnicë**, kodi i projektit nr.10041, në vlerë prej 150,000 €;
 - Ministria e Infrastrukturës e financon projektin me 120,000 €, ndarjet buxhetore për vitin 2021 janë 50,000 €, ndërsa për vitet në vijim mjetet buxhetore të parashikuara janë 70,000 €;
 - Komuna e Vushtrrisë e financon projektin me 30,000 €;
- Ndërtimi i rrugëve në fshatrat: Maxhunaj, Ropicë, Vilanc dhe Samadrexhë**, kodi i projektit nr.10041, në vlerë prej 180,000 €;
 - Ministria e Infrastrukturës e financon projektin me 150,000 €, ndarjet buxhetore për vitin 2021 janë 50,000 €, ndërsa për vitet në vijim mjetet buxhetore të parashikuara janë 100,000 €;
 - Komuna e Vushtrrisë e financon projektin me 30,000 €;

3. **Ndërtimi i rrugëve në fshatrat: Reznik, Mihaliq, Strofc dhe Novolan**, kodi i projektit nr.10041, në vlerë prej **130,000 €**;

- Ministria e Infrastrukturës e financon projektin me 100,000 €, ndarjet buxhetore për vitin 2021 janë 50,000 €, ndërsa për vitet në vijim mjetet buxhetore të parashikuara janë 50,000 €;
- Komuna e Vushtrrisë e financon projektin me 30,000 €;

Neni 3 **Obligimet e MI-së**

1. MI-ja i siguron mjetet për projektet nga paragrafi 2 i kësaj Marrëveshje dhe nga një kopje i dërgon Komunës.
2. Ç' do tejkallim i vlerës së planifikuar për projektet nga paragrafi 2 i kësaj Marrëveshje do të mbulohet nga Komuna.
3. Pagesat për financim të projekteve nga MI-ja do të bëhen në pajtim me realizimin e punimeve/furnizimeve sipas kushteve të kontratës. Pagesat bëhen nga MI-ja deri në vlerën e financimit.
4. MI-ja cakton një zyrtar për mbikqyrjen e realizimit të projekteve nga fillimi deri në përfundim të kontratës. MI-ja me vendim do të caktoj detyrat, përgjergjësitë dhe autozizimet e zyrtarit për mbikqyrje.

Neni 4 **Obligimet e Komunës**

1. Komuna siguron deklaratën e disponueshmërisë së mjeteve në tërësinë e vlerës së projektit dhe një kopje e dërgon në MI.
2. Komuna obligohet ti krijoj kushtet e nevojshme për realizimin e projekteve për operatorët ekonomik, të ndërmerr të gjitha masat që kontraktuesi pa pengesë të filloj në implementimin e projekteve me kohë si dhe të siguroj specifikacionet teknike.
3. Komuna obligohet që projektet të zhvilloj në pajtim me Ligjin mbi prokurimin publik dhe Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi si dhe aktet nënligjore për zbatimin e këtyre ligjeve.
4. Komuna e kryen procesin e tenderimit dhe cakton komisionin për hapjen e ofertave dhe vlerësim të tenderit.
5. Komuna emëron projekt menaxherin/organin mbikëqyrës për realizimin e projekteve, si dhe komisionin për inspektimin final të punimeve/pranimin teknik, në të cilin komision duhet të jetë një anëtar nga MI-ja.
6. Projekt menaxheri/organi mbikëqyrës me përgjegjësi të plotë vërteton sasinë dhe kualitetin e punëve/furnizimeve të kryera në bazë të cilave operatori ekonomik lëshon dokumentin financiar me kërkesë për pagesen e punëve/furnizimeve të kryera në bazë të kushteve të kontratës.

7. Komuna obligohet që të njofton MI-në për çdo propozim ndryshim eventual të sasisë dhe kualitetit gjatë implementimit të projekteve dhe për këtë të kërkojë pëlqimin nga MI-ja.

7.1. Komuna obligohet që në vend punishte të vendose tabelën informues (Pano) me shënimet për projektin, investitorët dhe operatorin ekonomik.

8. Komuna obligohet që për të realizuar pagesat për punët/furnizimet e kryera në nivel të financimit nga MI-ja të kompletoj këto dokumente:

8.1. Procesverbalin e hapjes së tenderit dhe raportin e vlerësimit të tenderit (si dhe në rastet e korrigjimit të çmimeve të dorëzohen dokumentet e korrigjuara);

8.2. Kopjen e Kontratës të nënshkruar me operatorin ekonomik, së bashku me ofertën financiare, të vertetuara në bazë të origjinalit nga menaxheri i prokurimit të Komunës;

8.3. Vendimi mbi emërimin e projekt menaxherit/organit mbikëqyrës dhe komisionin e pranimit nga ana e Komunës;

8.4. Raportin e projekt menaxherit/organit mbikëqyrës/komisionit të pranimit mbi punët/furnizimet e kryera dhe të aprovuara (situacionet e aprovuara);

8.5. Faturën origjinale nga operatori ekonomik deri në lartësinë e shumës së financuar nga MI-ja dhe

8.6. Kopjen e certifikatës së biznesit, llogarinë bankare dhe letërnjoftimin e pronarit të operatorit ekonomik (nëse nuk është i regjistruar në SMIFK-Departamenti i Thesarit-Ministria e Financave dhe Transfereve).

9. Komuna duhet të ndërmarr të gjitha masat që projektet të përfundoj në përputhje me ndarjet buxhetore sipas viteve për projektin e tillë. Pas këtij afati të gjitha obligimet kalojnë në përgjegjësi të Komunës.

10. Komuna është e obliguar të njoftoj MI-në për rrjedhat e realizimit të projektit sipas një plani dy javor deri në përfundim të projektit.

11. Komuna obligohet të ndërmarrë dhe kryej çdo lloj shpronësimi të nevojshëm për zbatimin e projekteve përfshirë procedurat dhe kompenzimin.

Neni 6

Ndryshimet dhe ndërprerja e Marrëveshjes

1. Me pëlqimin paraprak të Ministrit të MI-së dhe Kryetarit të Komunës, kjo Marrëveshje mund të ndryshohet dhe plotësohet.

2. MI-ja mbanë të drejtën e ndërprerjes së shfrytëzimit të buxhetit për këtë destinim në rast se konstaton se Komuna nuk i përmbush obligimet e veta të dala nga kjo Marrëveshje.

Neni 7
Zgjidhja e kontesteve

Palët janë pajtuar në mes veti që kjo Marrëveshje të zgjidhet me mirëkuptim.

Neni 8
Numri i Kopjeve


Marrëveshja për bashkëfinancim është nënshkruar në katër (4) kopje, nga dy (2) kopje për secilën palë nënshkruese.

Neni 9
Pronësia e Projektit

1. Me pranim dorëzimin e punëve të kryera nga operatori ekonomik, ky investim (projekt) do të kalojë në pronësi të Komunës.
2. Ky investim regjistrohet në pronësi të Komunës në mënyrë elektronike dhe fizike në sistemin e pasurisë në Ministrinë e Financave dhe Transfereve (SMIFK).

Neni 10
Hyrja ne fuqi

Palët nënshkruese janë pajtuar që kjo Marrëveshja për bashkëfinancim të fillon të zbatohet nga dita e nënshkrimit.

Ministri i MI-së

Arban ABRASHI


Kryetari Komune

Xhafer TAHIRI
